

**ERNST & YOUNG
ALBANIA SH.P.K.**

Pasqyrat Financiare deri më dhe për vitin ushtrimor
të mbyllur më 31 Dhjetor 2020

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Ortakët e Shoqërisë “ERNST & YOUNG ALBANIA SHPK”

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë “ERNST & YOUNG ALBANIA SHPK”(më poshtë “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK-të”).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (“SNA-të”). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* (Kodi i “BSNEPK”) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësinuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

► Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

► Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

► Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

► Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëriatë ndërpresë veprimtarinë.

► Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e "ERNST & YOUNG ALBANIA SHPK", përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Rezarta KOÇOLLARI

Adresa: Rr. Adem Seifi Kruja, Nr.6/1, 1, 5.

Telefon: 0672009416

Tiranë, Shqipëri
30 Qershor 2021

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 Dhjetor 2020

AKTIVET	Shënime	31 dhjetor 2020 LEK	31 dhjetor 2019 LEK
Aktive monetare	4	56,582,807	8,913,228
Të arkëtueshme	5	86,442,586	65,535,204
Të tjera aktive afatshkurtra	6	27,597,039	36,336,519
Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të përlllogaritura	7	15,139,154	17,754,125
Totali aktiveve afatshkurtra		185,761,586	128,504,410
Aktive afatgjata materiale	8	4,957,343	5,130,743
Aktive afatgjata financiare	9	125,790	125,790
Totali aktiveve afatgjata		5,083,133	5,256,533
TOTALI AKTIVEVE		190,844,719	133,760,943
Detyrimet dhe Kapitali			
Furnitorë dhe të tjera detyrime	10	25,872,633	9,877,456
Shpenzime të përlllogaritura	11	19,542,718	20,897,684
Totali i detyrimeve		45,415,351	30,775,140
Kapitali i paguar	12	100,000	100,000
Fitime të pashpërndara dhe rezerva		145,329,367	102,885,803
Totali i kapitalit		145,429,367	102,985,803
TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		190,844,719	133,760,943

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri 12 janë firmosur dhe aprovuar më 30 Mars 2021 nga:

Hartuesi

Anisa Josini

Aprovuar

Nikolay Garnev



Soana Dreni

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHPERFSHIRESE

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020 LEK	31 dhjetor 2019 LEK
Të ardhurat			
Të ardhurat nga shitja e shërbimeve		163,183,018	146,828,559
Totali i të ardhurave	13	163,183,018	146,828,559
Shpenzime operative			
Kosto e punës	14	(59,000,102)	(56,777,148)
Amortizimet dhe zhvlerësimet	8	(1,302,830)	(1,423,482)
Shpenzime administrative dhe të tjera	15	(55,216,346)	(64,449,192)
Totali shpenzimeve		(115,519,278)	(122,649,822)
Fitimi nga veprimtaritë kryesore		47,663,740	24,178,737
Fitimet nga kursi këmbimit, neto	16	2,801,546	(1,546,953)
Fitimi para tatimit		50,465,286	22,631,783
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	(8,021,723)	(4,081,146)
Fitimi neto e vitit financiar		42,443,563	18,550,637
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		-	-
Totali i fitimit dhe të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		42,443,563	18,550,637

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Shënime	31 dhjetor 2020 LEK	31 dhjetor 2019 LEK
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi përpara tatimit	50,465,286	22,631,783
Rregullime për:		
Amortizime dhe zhvlerësime	1,302,831	1,423,482
Shpenzime për interesat	-	-
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues	51,768,117	24,055,266
(Rritje)/Zvogëlim në tepicën e kërkesave të arkëtueshme dhe aktiveve të tjera	(9,587,597)	(16,244,098)
Rritje/(Zvogëlim) në tepicën e detyrimeve për t'u paguar nga aktiviteti dhe detyrimeve të tjera	10,782,134	(9,162,413)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	52,962,654	(1,351,245)
Tatim fitimi i paguar	(4,163,645)	(4,136,094)
Fluksi monetar neto (i perdorur) / nga veprimtaritë e shfrytëzimit	48,799,009	5,487,339
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,129,430)	(772,499)
Fluksi monetar neto i perdorur ne veprimtaritë e investimit	(1,129,430)	(772,499)
Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit		
Pagesa te huamarrjes	-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit	-	-
Rritja/(Zvogëlimi)/ neto e mjeteve monetare	47,669,579	(6,259,839)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	8,913,228	15,173,067
Mjetet monetare në fund të periudhës	4 56,582,807	8,913,228

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

	Rezerva ligjore	Fitime të pashpërndara	Totali
	LEK	LEK	LEK
Pozicioni në 1 Janar 2019	100,000	84,335,167	84,435,166
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:			
Fitimi i vitit	-	18,550,637	18,550,637
Totali i te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:	-	18,550,637	18,550,637
Totali i transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital	-	-	-
Pozicioni në 31 Dhjetor 2019	100,000	102,885,804	102,985,804
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:			
Fitimi i vitit	-	42,443,563	42,443,563
Totali i te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:	-	42,443,563	42,443,563
Totali i transaksione me pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:	-	-	-
Pozicioni në 31 Dhjetor 2020	100,000	145,329,367	145,329,367

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria Ernst & Young Albania Sh.P.K. është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me ligjin Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” datë 30.06.2010.

Ajo është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më datë 30.07.2010 me numër serial SN-104900-10-10 me numër unik identifikimi të subjektit NUIS: L01930009J.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e shërbimeve të konsulencës në lidhje me tatim/taksat, konsulencë për transaksione, vlerësime dhe shërbime konsulente për biznesin, auditime ligjore, transaksione që kanë të bëjnë me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, industrial, financiar, etj.

Administrator i shoqërisë është Z. Nikolay Garnev. Më 31 Dhjetor 2020 shoqëria kishte 31 punonjës (31 Dhjetor 2019 - 30 punonjës).

Që prej datës 01 Nëntor 2014, selia qendrore e shoqërisë është në adresën “Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 6”, Tiranë.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë aprovuar nga administratori më 30 Mars 2021.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

a. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të aplikueshme për pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat duke filluar nga 1 Janar 2020 deri me 31 Dhjetor 2020.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë të paraqitura në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

c. Aktivët afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

c) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura janë si më poshtë:

<u>Kategoria</u>	<u>Metoda e amortizimit</u>	<u>Norma e amortizimit</u>
Mobilie dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyrash dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Aktive të tjera të veprimtarisë	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivitetet afatgjata jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të ketë përfitime ekonomike që do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

d. Investimet në shoqëri të tjera

Investimet në shoqëri të tjera janë aksione në shoqëri të lidhura me afat maturimi të papërcaktuar dhe drejtimi i Shoqërisë ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë të mbajë deri në maturim. Këto aksione me vlerë klasifikohen si aktive financiare afatgjata, përveç aksioneve me vlerë që arrijnë afatin e maturimit brenda 12 muajve të ardhshëm nga data e bilancit dhe që njihen si afatshkurtra gjatë periudhës raportuese. Këto investime janë vlerësuar me kosto.

e. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

f. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

g. Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën kryesore të përdorur në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj është si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
1 EUR	123,70	121,77
1 USD	100,84	108,64

h. Të ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

i. Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2020.

j. Biznesi në vijimësi

Të dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të veçantë me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimësi.

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

Gjatë vitit 2020, pavarësisht pandemisë Covid 19, Shoqëria ka vazhduar shërbimet e saj, nuk ka pasur ndikim në të ardhurat financiare, dhe nuk pret më ndikime të mëtejshme negative nga këto rrethana.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël janë organizuar bazuar në ligjin për "Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Plani i llogarive, është në përputhje me SKK.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

4. AKTIVET MONETARE

Aktivitet monetare përbëhen nga Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Arka	49,765	139,612
- në Lek	35,934	66,269
- në monedhë të huaj	13,831	73,343
Llogari rrjedhëse	56,533,042	8,773,616
- në Lek	9,528,076	794,387
- në monedhë të huaj	47,004,966	7,979,229
	56,582,807	8,913,228

5. TË ARKËTUESHME

Të arkëtueshmet përbëhen nga klientët të cilët janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Klientë, palë të treta	39,380,512	30,871,410
Klientë, palë të lidhura	56,507,302	45,866,353
Provizjone për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme	(9,445,228)	(11,202,559)
	86,442,586	65,535,204

6. TË TJERA AKTIVE AFATSHKURTRA

Të tjera aktive përbëhen nga parapagimet për punonjësit, garanci të dhëna të tretëve për qiranë e zyrave dhe të tjera të drejta për tu arkëtuar.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Parapagimet për punonjësit	108,601	180,193
Garanci të dhëna	4,201,020	4,201,020
Palë të lidhura	23,287,418	31,865,693
Tatim fitimi	-	54,947
	27,597,039	36,301,854

7. SHPENZIMET E SHTYRA DHE TË ARDHURAT E PËRLLOGARITURA

Shpenzimet e shtyra dhe të ardhurat e përllogaritura përfshijnë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Të ardhura të përllogaritura	15,128,482	15,390,043
Shpenzime të periudhave të ardhshme	10,672	2,364,082
	15,139,154	17,754,125

Të ardhurat e përllogaritura kanë të bëjnë me të ardhurat që lidhen me pjesën e shërbimeve të kryera gjatë vitit 2020 por që janë faturuar në vitin 2021 sipas kushteve të përcaktuara me klientin në kontratën e angazhimit. Shpenzimet e periudhave të ardhshme (shpenzimet e shtyra) kanë të bëjnë me shpenzime të cilat i përkasin vitit 2021, por janë faturuar nga furnitorët gjatë vitit 2020.

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Mobilie dhe orendi LEK	Pajisje zyre dhe informatike LEK	Të tjera aktive të veprimtarisë LEK	Totali LEK
Aktivet me kosto				
Gjendja më 1 Janar 2019	900,416	3,611,274	3,361,665	7,873,355
Shtesat	116,250	720,745	-	836,995
Pakësimet	(5,167)	(228,900)	-	(234,067)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	1,011,499	4,103,119	3,361,665	8,476,284
Shtesat	573,207	674,357	-	1,247,563
Pakësimet	(73,033)	(243,317)	-	(316,350)
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	1,511,673	4,534,159	3,361,665	9,407,497
Amortizimi				
Gjendja më 1 Janar 2019	538,164	1,049,216	504,250	2,091,630
Shtesat	81,320	770,680	571,482	1,423,482
Pakësimet	(5,167)	(164,404)	-	(169,571)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	614,317	1,655,492	1,075,732	3,345,541
Zhvlerësimi i akumuluar per vitin	193,797	651,848	457,185	1,302,830
Pakësimet	(73,033)	(125,185)	-	(198,218)
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	735,081	2,182,155	1,532,917	4,450,154
Vlera e mbetur				
Më 31 Dhjetor 2019	397,182	2,447,628	2,285,933	5,130,742
Më 31 Dhjetor 2020	776,592	2,352,004	1,828,748	4,957,343

9. AKTIVET AFATGJATA FINANCIARE

Aktivet afatgjata financiare përfaqësojnë vlerën e aksioneve që Shoqëria zotëron si aksionere e shoqërisë EY Global Finance Inc. që prej datës 10 Gusht 2011. Ajo zotëron 1 aksion në vlerën 1,000 USD ose ekuivalentë në 125,790 LEK.

10. FURNITORË DHE TË TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA

Të pagueshmet ndaj furnitorëve dhe të tjera detyrime afatshkurtra janë analizuar si më poshtë.

	31 dhjetor 2020 LEK	31 dhjetor 2019 LEK
Furnitorë	3,179,417	2,262,920
Palë të lidhura	15,692,648	4,982,019
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	794,475	868,861
Tatimi mbi të ardhurat personale	586,185	529,744
TVSH për tu paguar	1,761,831	1,233,912
Tatim fitimi	3,858,078	-
	25,872,634	9,877,456

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

11. SHPENZIMET E PËRLLOGARITURA DHE TË ARDHURAT E SHTYRA

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Shpenzimet e përlogaritura	19,295,318	20,120,981
Të ardhurat e shtyra	247,400	776,703
	19,542,718	20,897,684

Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020 janë përfshirë shpenzime të përlogaritura të cilat lidhen me shërbime të furnizuara (të marra) gjatë vitit 2020, faturat për të cilat janë marrë gjatë vitit 2021. Sipas parimit të të ardhurave dhe detyrimeve të konstatuara këto shpenzime janë njohur në vitin fiskal të cilit i përket. Gjithashtu, sipas të njëjtit parim janë llogaritur edhe të ardhurat e shtyra, faturat për të cilat janë lëshuar në vitin 2020, por i përket vitit 2021.

12. KAPITALI AKSIONAR

Kontributi në kapitalin e shoqërisë Ernst & Young Albania Sh.P.K. është ofruar si më poshtë:

- 1- Shoqëria Ernst & Young Central and Southeast Europe Public Limited, shoqëri e të drejtës qipriote; 99 kuota që i korrespondojnë 99 % të kapitalit të shoqërisë.
- 2- Shoqëria Ernst & Young Beograd doo, shoqëri e të drejtës serbe; 1 kuotë që i korrespondon 1 % të kapitalit të shoqërisë.

13. TË ARDHURAT

Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	163,183,018	146,828,559
	163,183,018	146,828,559

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

14. KOSTO E PUNËS

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Paga dhe shpërblime	53,349,537	51,473,080
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	5,650,565	5,304,068
	59,000,102	56,777,148

15. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Shpenzime qiraje	6,082,473	5,228,000
Shpenzime konsulence	14,955,571	18,459,142
Shpenzime për udhëtime e dieta	2,629,936	5,061,658
Shpenzime edukimi i jashtëm	990,175	1,519,730
Shpenzime postare e telekomunikacioni	1,553,926	1,693,032
Shpenzime abonimi	179,747	280,421
Të tjera shpenzime	27,837,571	28,382,868
Shërbime menaxhimi	1,172,799	3,062,947
Provizgjone për borxhin e keq	302,818	606,394
Rimarrje e provizgjone për borxhin e keq	(643,670)	-
Shpenzime auditimi	155,000	155,000
	55,216,346	64,449,192

16. TË ARDHURA/(SHPENZIME) FINANCIARE

Fitime / (humbje) nga kurset e këmbimit janë analizuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Fitime nga kurset e këmbimit	3,280,397	314,150
Humbje nga kurset e këmbimit	(478,851)	(1,861,103)
	2,801,546	(1,546,953)

17. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2020 (15% për vitin 2019).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2020 Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël dhe një fitim fiskal (në vitin 2019 fitim kontabël dhe një fitim fiskal) si më poshtë:

Ernst & Young Albania Sh.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

Detyrimet për tatim fitimin janë përlogaritur si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
	LEK	LEK
Fitim / (humbja) para tatimit	50,465,286	22,631,783
<i>Zëra shpenzimesh të panjohura:</i>	3,012,866	4,575,860
Fitimi fiskal	53,478,152	27,207,643
(Humbje) të mbartura	-	-
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Shpenzim tatim fitimi për vitin	8,021,723	4,081,146

18. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të ishte e nevojshme të paraqitshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.